

V E N D I M

Date 13 Nentor 2024

Vendim i Ortakut te Shoqërisë " EASY-BALI " sh p k

Ne mbledhjen e ortakut te datës 13 Nentor 2024, ortakut i Shoqërisë vendosi te marrë këtë vendim. Me këtë vendim qe ka vlere ligjore, i Ortakut të Shoqërisë "EASY-BALI" sh.p.k, z. Denis Bali, Me rendin e ditës:

1. Miratimin e dhurimit te 100% te kapitalit te Shoqërisë "EASY-BALI" shpk qe zotërohen Ortaku i kësaj Shoqërie z. Denis Bali ne drejtim te Zj. Urana Boshnjaku me ID H96022103H.
2. Përfaqësimi i shoqërisë nga Administratori Zj. Urana Boshnjaku ne vijimësi.

Ortakut i Shoqërisë është si me poshtë:

- a. Ortaku z. Denis Bali është zotërues i 100% te kapitalit te shoqërisë

Duke qene se:

Shoqëria "EASY-BALI" sh.p.k është shoqëri shqiptare me Përgjegjësi te kufizuar ne seli ne Rruga Khanfize Keko, Godina 583 Njësia Bashkiake Nr. 3 Tirane regjistruar pranë QKB me NUIS M42026023E ("Shoqëria") ortakut i kësaj shoqërie vendos unanimsisht qe:

1. Ortaku i Shoqërisë dhe kuotat e zotëruara nga ai do te jene si vijon:
 - a. Ortaku Zj. Urana Boshnjaku pas dhurimit te bere nga z. Denis Bali, do te jete zotërues i 100% te kapitalit themeltar te Shoqërisë
2. Vendoset qe përfaqësimi i Shoqërisë te kryhet nga Administratori Zj. Urana Boshnjaku me ID H96022103H.

PER KETO ARSYE anëtarët e Asamblesë se Përgjithshme VENDOSËN UNANIMISHT:

1. Te miratojë transferimin e pronësisë me anë të dhurimit te 100% te kapitalit themeltar nga Ortaku z. Denis Bali te Zj. Urana Boshnjaku ne përputhje me kontratën respektive bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Përfaqësimi i Shoqërisë te kryhet nga Administratori Zj. Urana Boshnjaku

Ortakut i Shoqërisë

Denis Bali



Denis Bali

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot në Datë 13 Nentor 2024 në ambientet e Shoqërisë “EASY-BALI” shpk hartohet kjo kontratë Dhurimi kuotash për sa më poshtë:

Palët:

DHURUESI: Z. Denis Bali i biri i Arjanit, lindur në Tirane më 18 Qershor 1991 me shtetësi dhe kombësi Shqiptare, dhe banues në Tirane në adresën Rr. Kongresi Manastirit shtëpi private Nr 44, Njesia Bashkiake 4, Tirane me ID J10618068R, madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si “Pala Dhuruese”

PERFITUESI: Zj. Urana Boshnjaku i datëlindjes 22 Tetor 1979 e bija e Stavrit, lindur në Tirane dhe banues në adresën: Rruga Petro.Nini Luarasi, Pall.10/1 Shk 2 Ap 14 Tirane, identifikuar me kartën e identitetit me ID H96022103H madhor dhe me zotësi juridike të plotë për të vepruar, këtu e më poshtë referuar si “Pala Perfituese”

Palët e mësipërme bazuar në legjislacionin tregtar dhe dispozitat e Kodit Civil, përpiluan këtë kontratë për dhurimin në total të 100% të kuotave të Shoqërisë Tregtare “EASY-BALI” shpk me numër unik identifikimi subjekti NIPT M42026023E.

PREAMBUL


Shoqëria “EASY-BALI” shpk është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” me seli në Tiranë, Tirane Rruga Xhanfize Keko, Godina 583 Njësia Bashkiake Nr. 3 Tirane dhe zotërohet në masën 100% të kapitalit themeltar nga ortaku i vetëm Z. Denis Bali. Kjo shoqëri ka për objekt të veprimtarisë së saj Rimbushje elektronike dhe pagesa online. Agjent i shoqërisë EASY Pay (Institucion i parasë elektronike), për kryerjen e shërbimeve që përfshijnë por nuk kufizohen në pagesa faturash dhe transferta parash, shitje të mallrave/shërbimeve të partnereve të EASY Pay, rimbushje elektronike, prerje bileta udhëtimi, shërbime të tjera elektronike etj. Konsulenca Ligjore. Këmbim Valutor.Si edhe çdo shërbim tjetër të ligjshëm me përfitues finale individë dhe subjekte jashtë territorit Shqiptar.

Dhurimi i kuotave të kësaj shoqërie nga pala dhuruese te pala përfituese, është lejuar me vendim të Ortakut të Vetëm z. Denis Bali, në përputhje me legjislacionin tregtar në fuqi dhe statutin e shoqërisë.

Palët me vullnet të lirë dhe të pavesuar, bazuar në nenet 73, 74 dhe 75 e vijues të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, dispozitat e ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” si dhe dispozitat e Kodit Civil disponojnë si më poshtë vijon:

OBJEKTI

Me anë të kësaj kontrate, Pala Dhuruese e cila zotëron 100% (njëqind përqind) të pjesëve të kapitalit në Shoqërinë EASY-BALI shpk me dëshirën e tij i dhuron dhe i transferon 100% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë Tregtare EASY-BALI shpk, Palës Përfituese Zj. Urana Boshnjaku, e cila është dakord t’i pranojë ato.



KALIMI I PRONËSISË

Që nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate dhurimi, Z. Denis Bali humb cilësinë e pronarit mbi 100 (njëqind për qind) të kuotave të Shoqërisë EASY-BALI shpk dhe ortaku i vetëm i kapitalit themeltar të kësaj shoqërie do të jetë përfituesi Zj. Urana Boshnjaku e cila bëhet pronar i vetëm i ligjshëm i kapitalit themeltar me 100% (njëqind për qind) të pjesëve të kapitalit të Shoqërisë EASY-BALI shpk.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë sipas legjislacionit në fuqi nga titulli i pronësisë mbi këto kuota, objekt i kësaj kontrate, që nga data e nënshkrimit të saj, i kalojnë përfituesit. Përfituesi bëhet zotërues me të drejta të plota të këtyre kuotave në shoqërinë EASY-BALI shpk.

GARANCITË DHE DEKLARATA


Dhuruesi garanton Përfituesin, se kuotat objekt kontrate, nuk janë objekt pengu dhe janë të lira nga çdo lloj titulli e natyre të të tretëve. Nga momenti i nënshkrimit të kësaj kontrate Dhuruesi humbet çdo të drejtë që rrjedh nga zotërimi i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë dhe nga dhurimi i tyre objekt kontrate, Përfituesi bëhet pronar i vetëm i ligjshëm i tyre, me 100% (njëqind për qind) të pjesëve të kapitalit ose të 100 (njëqind) kuotave në kapitalin themelor të Shoqërisë EASY-BALI shpk.

LIGJI I APLIKUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

1. Kjo kontratë rregullohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
2. Palët bien dakort për çdo mosmarrëveshje që lind në lidhje me vlefshmërinë interpretimin apo zbatimin e kësaj kontrate të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
3. Një kopje e kësaj kontrate do të depozitohet nga përfituesi ose administratori në QKB për efekt të regjistrimit të kalimit të kuotave të shoqërisë në favor të tij.
4. Dokumenta bashkëngjitur kësaj kontrate ; a- letërnjotim të palëve kontraktore, b- vendimi i ortakut të vetëm të Shoqërisë

PALËT

DHURUESI

Denis Bali


PERFITUESI

Urana Boshnjaku
